



INSPEKTORATI KOMBËTAR I
MBROJTJES SË TERRITORIT
Nr. 440 Prot.
Datë 24 01 .2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

**RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT
DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
NË INSPEKTORATIN
KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT
(IKMT)**

Tiranë, më 24/01 2018

ADRESA: Rruga "Muhamet Gjollesha", pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Tel. 223 933

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza Ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, bazohet në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në bazë të urdhërave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Neni 3

Përkufizime

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1."I Sinjalizuar janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
- 2."Njësia përgjegjëse" është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrative të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
- 3."Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.
4. "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësi përgjegjëse për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin public apo subjektin privat.
- 5."Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit public apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies

së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

6. "Subjekt privat" është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

7. "Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, së mund të përbëjë korrupsion.

8. "ILDKPKI" është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

KREU II

VEPRIMTARIA E IKMT-së

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

1. Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", bazohet në parimin e:

- a. ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror;
- b. njohjes së identitetit të sinjalizuesit, përveç rastit kur ligji lejon pranimin e një sinjalizimi anonim;
- c. sinjalizimit vullnetar të një veprimi ose praktike të dyshuar të korrupsionit;
- d. integritetit dhe paanshmërisë gjatë shqyrtimit të sinjalizimit;
- e. zbatimit të mekanizmave të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- f. procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU III

PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 5

Kryerja e veprimeve proceduriale

1. Veprimet proceduriale të njësive përgjegjëse kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative
2. Njoftimet për veprimet procedural, për të cilat njësia përgjegjëse cakton afate, duhet të përbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.

2. Sinjalizimi përmban të paktën:

a. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;

b. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit

c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;

d. referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;

e. në rastin e sinjalizimit tek njësia përgjegjëse shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonym dhe sinjalizimi pranohet nga njësia përgjegjëse s'ii tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

4. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;

a. sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;

b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;

c. kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

2. Mosfillimi i hetimit administrative bëhet me vendim të arsyetuar të njësisë përgjegjëse të IKMT-së.

Neni 8

Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

1. **ILDKPKI** heton drejtpërdrejtë sinjalizimin për veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në organizata, të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprimet e dyshuar të korrupsionit tek **ILDKPKI** në rastet kur;

a. njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;

b. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësisë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;

c. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;

d. prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, çdo hetim i njësisë përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga **ILDKPKI**. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, njësia përgjegjëse, me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrative tek organi kompetent.

KREU IV

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.

2. Njësia përgjegjëse nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Parimet e hetimit administrative nga IKMT-ja

1. Në kryerjen e hetimit administrative njësia përgjegjëse IKMT vepron:

- a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interes legjitim të sinjalizuesit;
- b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
- c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
- d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 11

Procedura e hetimit administrativ

1. Njësia përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i-garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argument ose opinion;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
 - c. ka të drejtë të dëgjohej në lidhje me pretendimet e tij.
5. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve

nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

6. Njësia përgjegjëse merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

7. Nëse në përfundim të hetimit administrative nga njësia përgjegjëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, njësia përgjegjëse sipas rastit, vë në dijeni organin competent.

Neni 12

Provat në hetimin administrativ

1. Njësia përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrative. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrative merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.

2. Njësia përgjegjëse ka të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacionin me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.

3. Në raste të veçanta, njësia përgjegjëse vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, njësia përgjegjëse bllokoi dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga anëtarët e njësisë përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Kryetarit të njësisë përgjegjëse.

4. Gjatë ushtrimit të detyrës njësia përgjegjëse zbaton, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e procedurave Administrative.

5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga njësia përgjegjëse dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU VI

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 16

Afati për vendimarrjen

1. Procedura e hetimit administrative të sinjalizimit nga njëسيا përgjegjëse përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
 2. Shtyrja e afatit për hetimin administrative bëhet me vendim të arsyetuar të njësisë përgjegjëse duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.
- Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

